



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

**UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK**

VENDIM

Nr. 12, datë 09.04.2019

MBI

**“SHPLLJEN E ZGJEDHJEVE TË REJA, PËR POZICIONIN E PËRGJEGJËSIT
TË DEPARTAMENTIT SKULPTURË, NË FAKULTETIN E ARTEVE TË BUKURA,
TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE”**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, në mbledhjen e datës 09.04.2019, mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimin e Senatit Akademik nr. 4, datë 23.01.2019 “Për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ), në Universitetin e Arteve”; Rregulloren e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë me nr. 2459/1 prot., datë 15.03.2016 “Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe duke marrë në konsideratë se Përgjegjësi i Departamentit të Skulpturës në Fakultetin e Arteve të Bukura, ka dhënë dorëheqjen, për këtë arsye,

V E N D O S I:

1. Shpalljen e zgjedhjeve të reja, për pozicionin e Përgjegjës të Departamentit Skulpturë, në Fakultetin e Arteve të Bukura, të Universitetit të Arteve.
2. Ngarkohet Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ) në Universitetin e Arteve, i zgjedhur me Vendimin e Senatit Akademik nr. 4, datë 23.01.2019 “Për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ), në Universitetin e Arteve”, të marrin masat e nevojshme për miradministrimin e procesit zgjedhor në UART.
3. Ngarkohet Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ), që brenda 30 ditëve kalendarike, të ketë përfunduar procesi zgjedhor për pozicionin e Përgjegjës të Departamentit Skulpturë, në Fakultetin e Arteve të Bukura.
4. Ngarkohet Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ), që pas mbarimit të procesit zgjedhor, vendimin e shpalljes së fituesit, për pozicionin e Përgjegjës të Departamentit Skulpturë, në Fakultetin e Arteve të Bukura. ta dërgojë pranë Rektorit të Universitetit të Arteve.
5. Ky vendim ti dërgohet Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ).

